



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 57 dt.08.05.1995

**“MBI DISA MASA PER DISIPLINIMIN E VEPRIMTARIVE  
NE FUSHEN E KULTURES”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1995, pasi shqyrtoi relacionin e parqitur nga Seksioni i Kulturës “Për një përmirësim dhe disiplinim të veprimtarive kulturore, artistike dhe sportive në qytetin e Tiranës”, në mbështetje të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

**VENDOSI**

1. Të gjithë Institucionet shtetërore e private që zhvillojnë veprimtari publike si Teatër, Estrada Cirku, Qendra dhe Agjensi Kulturore Kombëtare Lokale, ansamble e shoqëri kulturore, kinema, ekspozita, spektakle televizive, publike(në salla), stadione, salla koncertesh e shtëpi rinie etj, duhet të paraqesin pranë Seksionit të Kulturës së Bashkisë Tiranës programet e veprimtarive që do të zhvillojnë të miratuara nga drejtoritë e tyre ose përgjegjësit e njohur me ligj, dy javë para ditës së caktuar për shfaqje.
2. Në qoftë se veprimtaria për arsye të ndryshme nuk zhvillohet organi kompetent duhet të lajmërojë

Bashkinë e Tiranës me shkrim, duke shpjeguar edhe arsyet përse nuk zhvillohet një veprimtari e planifikuar.

3. Për të organizuar jetën kulturore artistike e sportive në qytetin e Tiranës të gjithë drejtoritë e institucioneve kulturore, artistike e sportive, shoqatat dhe agjensitë me karakter kulturor ose zyrtar e programacionit të autorizuar prej tyre, çdo fund javë, ditën e premte deri në orën 12.00 duhet të paraqesin pranë Seksionit të Kulturës së Bashkisë programet e shfaqjes të javës së ardhme duke përcaktuar titullin e shfaqjes, ditën dhe orën e saktë dhe vendin (sallën) ku zhvillohet veprimtaria kulturore ose sportive.
4. Reklamat e shfaqjeve publike që afishohen në qytet duhet të jenë të miratuara nga Bashkia, ato duhet tu përgjigjen standarteve bashkëkohore, për këtë qëllim lejimi për afishimin e tyre duhet të bëhet me miratim të Seksionit të Kulturës së Bashkisë. Të gjitha reklamat të shkruhen në gjuhën amtare.
5. Të gjitha subjektet shtetërore e private për emërtimin e lokaleve apo veprimtarive publike duhet të paraqesin pranë "Komisionit të emërtimeve të qytetit të Tiranës" në Bashkinë e Tiranës propozimet e tyre me shkrim për titullin që mendojnë të emërtojnë veprimtarinë e tyre. Për lejen e këtij komisioni ato quhen të paligjshme, dhe ju nënshtrohen sanksioneve të përcaktuara në ligjin e pushtetit lokal.
6. Të gjitha shoqatat me karakter social – kulturor, sportiv, artistik, fetar, fondacione e shoqëri të përbashkëta që kryejnë veprimtarinë e tyre në qytetin e Tiranës deri më 31 Mars 1995 të paraqesin në Bashki, pranë Sek.të Kulturës dokumentin zyrtar të mbështetur në ligj, nga dikasteri e institucioni që e ka kompetencë, llojin e veprimtarisë që kryejnë, adresën nr.telefonit, pasi regjistrohen në "Librin e Shoqatave" që kryejnë veprimtari në Tiranë.

Këtij vendimi i nënshtrohen edhe të gjithë ato shoqata që nuk e kanë qendrën në Tiranë, por degët e tyre zhvillojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë së Qytetit Tiranës.

7. Mos zbatimi i këtij vendim ngarkon me përgjegjësi organizmat përkatëse deri në pezullimin e aktivitetit dhe në raste të përsëritura do t'ju nënshtrohen sanksioneve që parashikohen në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**